



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.273, datë 16.09.2021

**PËR CAKTIMIN E NJË ANËTARI NGA RADHËT E PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR NË BORDIN DREJTUES TË QENDRËS SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT PËR SISTEMIN E DREJTËSISË**

Bazuar në nenet 92, 159 dhe 189, të Ligjit nr. 115/2016, “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pikat 9/e, 9.2, 25 dhe 27, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020, “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”, si dhe me propozim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Të caktojë Z. Sotir Kllapi, prokuror në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si anëtar me të drejtë vote në Bordin Drejtues të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.
2. Të njoftohet për këtë vendim Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, prokurori Sotir Kllapi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**



**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
MOISI DUDA**

**ANËTAR  
VATË STAKA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**